

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-32/022	Data: Datum: 01.02.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), më qellim të formimit të komisionit për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për përkrahje financiare në shëndetësi, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për përkrahje financiare në shëndetësi, dhe në Komision caktohen:

1. **Brahim Hetemaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi, Kryesues i Komisionit;
2. **Fisnik Shoshi**, Zyrtar Ligjor, anëtar dhe
3. **Fjollë Berisha**, Zyrtare e lartë për Personel, anëtare.

2. Komisioni i lartcekur obligohet që për çdo muaj ti shqyrtoj të gjitha kërkesat e qytetarëve që kanë kërkuar ndihmë financiare për shërim dhe ti caktoj kriteret për përkrahje financiare.

3. Për çdo takim të mbahet procesverbal si dhe të përpilohet lista e përfituesve dhe të caktohet shuma e mjeteve financiare për secilin.

4. Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të hartojë Vendim për secilin përfitues të ndihmës financiare, ndersa ata që nuk mund të përkrahen të njoftohen me shkrim.

5. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do ti kryejë: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

6. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br. 01-33/2022	Data: Datum: 01.02.2022	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit rivlerësues lidhur me aktivitetin e prokurimit për projektin: “Asgjësimi i Mbetjeve Medicinale”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-8090-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni rivlerësues lidhur me aktivitetin e prokurimit për projektin: “Asgjësimi i Mbetjeve Medicinale”; me numër të jashtëm prokurimi 633-021-8090-2-2-1, dhe në komision caktohen:

- 1.1. Naser Gjocaj,** Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Sevdije Shabanaj,** Kryeinfermiere, QKMF-Istog, anëtare dhe
- 1.3. Arlinda Demaj,** anëtare.

2. Komisioni i cetur me lartë, ka për obligim që të bëjë rivlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit për projektin: “Asgjësimi i Mbetjeve Medicinale” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit rivlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për rivlerësimin lidhur me aktivitetin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdësen: Komisioni, Prokurimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ**



**Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI**



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-34/022	Data: Datum: 01.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), nenin 10 paragrafi 4 nenin 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.13/2019) nenin 21 dhe 26 të Ligjit 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike shqyrtoj kërkesën 01-016-3708 të datës 25.01.2022 të parashtruar nga Doruntina Baliu, gazetares në Radio Evropa e Lirë dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike.

1. MIRATOHET: propozimi i Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike për miratimin e kërkesës 01-016-3708 të datës 25.01.2022 si e bazuar për qasje në dokumente publike e parashtruar nga Doruntina Baliu, gazetares në Radio Evropa e Lirë dhe i lejohet qasja e plotë në dokumentet e kërkuara si me poshtë.

- Çfarë lloj(firme) e kamerave dhe kur janë instaluar ato;
- Kur është bërë blerja e këtyre kamerave dhe kur janë instaluar ato;
- Sa shkolla të Komunës tuaj janë të pajisura me kamera të sigurisë dhe të çfarë lloji janë ato;
- Ju lutem na jepni qasje në kontratën për blerjen e këtyre kamerave apo sistemit të video-mbikëqyrjes.

2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

3. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Doruntina Baliu, gazetares në Radio Evropa e Lirë ka parashtruar kërkesë Nr.01-016-3708 te datës 25.01.2022 për qasje në dokumente publike.

Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike ka shqyrtuar kërkesën si të bazuar dhe pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës i propozoj Kryetarit të vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetari e shqyrtoj propozimin e Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe e miraton lejimin e qasjes në dokumente publike si në pikën 1 të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 ditëve nga data e pranimi të tij.

Vendimi u dërgohet: **Doruntina Baliu**-parashtruesës së kërkesës, Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
 Zllir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-55/2022	Data: Datum: 14.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-1385, të datës 10.01.2022, të parashtruar nga z.Shemsedin Berisha nga fsh.Staradran, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e vajzes se tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-1385, të datës 10.01.2022, e parashtruar nga z.Shemsedin Berisha, për përkrahje me karburant për dërgimin e Vajzes se tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore, dhe i lejohen 40 litra karburant për muaj në kohezgjatje prej 6 muaj.
2. Parashtruesi i kërkesës: Shemsedin Berisha, obligohet që pas perfundimit të muajit të sjellë raportet e mjekut për vizitat e realizuara, në te kunderten i nderpritet furnizimi i metutjeshëm.
3. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Shemsedin Berisha, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
5. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Shemsedin Berisha, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-1385, të datës 10.01.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se: Vjona Berisha, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për në Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Shemsedin Berisha, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-56/022	Data: Datum: 14.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), nenin 10 paragrafi 4 nenin 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.13/2019) nenin 21 dhe 26 të Ligjit 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike shqyrtoj kërkesën 01-034-6129 të datës 14.02.2022 të parashtruar nga Leorenta Alija monitoruese në "IMPO" nga Prishtina dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike.

1. MIRATOHET: propozimi i Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike për miratimin e kërkesës 01-034-6129 të datës 14.02.2022 si e bazuar për qasje në dokumente publike e parashtruar nga Leorenta Alija monitoruese në "IMPO" nga Prishtina dhe i lejohet qasja e plotë në dokumentet e kërkuara si me poshtë.

- Raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin fiskal 2021;
- Kontratat e nënshkruara për punë shtesë gjatë vitit 2021 dhe vlera e tyre;
- Aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2021 dhe vlera e tyre.

2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

3. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Leorenta Alija monitoruese në "IMPO", ka parashtruar kërkesë 01-034-6129 të datës 14.02.2022 për qasje në dokumente publike.

Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike ka shqyrtuar kërkesën si të bazuar dhe pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës i propozoj Kryetarit të vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetari e shqyrtoj propozimin e Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe e miraton lejin e qasjes në dokumente publike si në pikën 1 të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 ditëve nga data e pranimit të tij.

Vendimi u dërgohet:

- Leorenta Alija monitoruese në "IMPO",
- Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-58/022	Data: Datum: 16.02.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/2008), për emërimin e Skender Hakaj, Zyrtar financiar për planin e rrjedhjes së parasë për Organizatën Buxhetore-Komuna Istogut për vitin fiskal 2022, për të cilin kërkohet qasje në SIMFK, nxjerr:

V E N D I M

- 1. EMËROHET:** Skender Hakaj me titull të vendit të punës Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financiar në Arsim në funksion Zyrtar financiar për planin e rrjedhjes së parasë për Organizatën Buxhetore-Komuna Istogut për vitin fiskal 2022.
2. Skender Hakaj obligohet që të përdor SIMFK sipas Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisitë dhe akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Skender Hakaj dhe ZKF.

Vendimi u dërgohet:

- Skender Hakaj,
- ZKF,
- MFPT-DTHK,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
 Z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-59/2022	Data: Datum: 16.02.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e datës 15.02.2022 të Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e komunës se Istogut”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-447-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-001-321, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e komunës se Istogut”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-447-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-001-321 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Genc Ademaj,** Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për partneritet publiko-privat, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Brahim Hetemaj,** Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi, anëtar dhe
- 1.3. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e komunës se Istogut” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Prokurimi.

Vendimi u dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-60/022	Data: Datum: 16.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), nenin 15 paragrafit 1 dhe nënparagrafi 1.1. të Rregullores Nr.07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, për emërimin e zyrtarit kontaktues për themelimin e Rrjetit për Politika të Gjuhëve, nxjerr:

V E N D I M

1. **EMËROHET: Blerim Gerguri**, Zyrtar kontaktues për përdorimin e gjuhëve si person kontaktues i cili do të jetë pjesë e Rrjetit për Politika të Gjuhëve.
2. Zyrtari kontaktues i lartcekur do të bashkëpunoj me Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve, për të siguruar respektimin e obligimeve të politikave për gjuhë duke zbatuar dispozitat e Rregullores Nr.07/2012 dhe dispozitat tjera në fuqi.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Blerim Gerguri.
5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi u dërgohet:

- Blerim Gerguri,
- Zyrës së Komisionerit për Gjuhë
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-77/022	Data: Datum: 21.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 10 paragrafi 4 nenin 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/2019) nenin 21 dhe 26 të Ligjit 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike shqyrtoj kërkesën 01-034-6572 të datës 16.02.2022 të parashtruar nga Isuf Gjocaj nga fsh. Kovragë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M Për qasje në dokumente publike.

1. MIRATOHET: propozimi i Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike për miratimin e kërkesës 01-034-6572 të datës 16.02.2022 si e bazuar për qasje në dokumente publike e parashtruar nga Isuf Gjocaj dhe i lejohet qasja e plotë në dokumentet që ka kërkuar për vazhën e tij Blerina Gjocaj, si me poshtë:

1.1. Dokumentet-lënda e subvencioneve për vitin 2021 të Blerina Gjocaj.

2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

3. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Isuf Gjocaj ka parashtruar kërkesë 01-034-6572 të datës 16.02.2022 për qasje në dokumente publike për vazhën e tij Blerina Gjocaj e cila ka aplikuar për subvencione në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përmes Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi në vitin 2021.

Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike ka shqyrtuar kërkesën si të bazuar dhe pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës i propozoj Kryetarit të vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetari e shqyrtoj propozimin e Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe e miraton lejin e qasjes në dokumente publike si në pikën 1 të këtij Vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 ditëve nga data e pranimi të tij.

Vendimi u dërgohet:

-Isuf Gjocaj,

-Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-78/022	Data: Datum: 21.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe nenin 17, paragrafi 1 shkronja e). të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28) në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, shqyrtoj kërkesën me referencë 11/351-17/2022 të datës 21.02.2022 të parashtruar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis për shfuqizimin e Vendimit 01Nr.78/2019 të datës 13.03.2019 dhe nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni profesional prej tre anëtarëve për shqyrtimin dhe vlerësimin e Raporteve për dhënien e Lejeve Mjedisore Komunale dhe në Komision caktohen:

- 1.1. Elfete Blakaj,** Kimiste, Kryesuese e Komisionit;
- 2.2. Bushat Gashi,** gjeodet, anëtar;
- 3.3. Naser Nimanaj,** inxh. i Komunikacionit, anëtar;

2. Komisioni i lartcekur ka për obligim të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e Raporteve për Dhënien e Lejeve Mjedisore Komunale; të përpiloj procesverbalin për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe ti paraqet masat për zvogëlimin e ndikimit në mjedis, pastaj të vazhdohej me procedurën administrative për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale.

3. Komisioni Profesional për shqyrtimin dhe vlerësimin e Raporteve për dhënien e Lejeve Mjedisore Komunale do të filloj punën nga data 21.02.2022 deri me 31.12.2022 si dhe duhet të formoj regjistrin e Lejeve mjedisore komunale.

4. Obligohet Komisioni që pas dhënies së lejes mjedisore të njoftoj Drejtorin e Inspekcionit me dhënien e lejes mjedisore që menjëherë të filloj me mbikëqyrje inspektuese duke zbatuar dispozitat e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale.

5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi u dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.80/2022	Data: 21.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58 pika f) të Ligjit për Qeverisjen Lokale Nr.03/L-040 si dhe nenin 72, paragrafi 72.2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Agim Ademaj**, Jurist i diplomuar, me vendbanim në Istog, Komuna e Istogut, deri tani Nënkyetar i Komunës i pushon mandati i Nënkyetarit të Komunës, për shkak të kalimit në detyrë të re.
2. Obligohet Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime të bëjë kërkesën, në Departamentin e Shërbimit Civil – Divizioni për Paga dhe Mëditje, në Ministrinë e Administratës Publike, për largimin e të përmendurit nga lista e pagave prej datës 28.02.2022.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: z. Agim Ademaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës,
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.80/2022	Data: 21.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), nenit 4 nënparagrafi 2.1. i paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, nxjerr:

V E N D I M

1. z. **Agim Ademaj**, Jurist i diplomuar, me vendbanim në Istog, Komuna e Istogut, emërohet: Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës.
2. Shefi i Kabinetit, i cekur më lartë, do t'i kryejë punët administrativo-teknike, duke përfshirë ofrimin e mbështetjes Kryetarit të Komunës në realizimin e përgjegjësiave të tij; do të aranzhojë dhe njoftojë Kryetarin me takimet të cilat i ka të caktuara apo takime të ndryshme të cilat do të caktohen nga Kryetari, që janë në natyrën e punës së Kabinetit të Kryetarit.
3. I përmenduri me kryerjen e punëve dhe përgjegjësiave të Shefit të Kabinetit do t'ia fillojë më 01.03.2022 dhe mandati i tij zgjatë sa mandati i Kryetarit të Komunës.
4. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.01/2018 MAPL për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna.
5. Obligohet Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime të pëfshijë të përmendurin në listën e pagave e pagës të fillojë nga data e cekur në pikën 3. Të këtij Vendim, në pajtim me procedurat në fuqi.
6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Menaxheri i Personelit dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: z. Agim Ademaj, Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.79/2022	Data: 21.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58 pika f dhe neni 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 72, Paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për emërimin e Nënkyetarit të Komunës, nxjerr:

V E N D I M

1. z.Ali Nimanaj, Jurist i diplomuar, me vendbanim në Istog, Komuna e Istogut, emërohet Nënkyetar i Komunës.
2. Me ushtrimin e funksionit të Nënkyetarit të Komunës i përmenduri do t'ia fillojë nga: 01.03.2022
3. Mandati i të emëruarit është i njëjtë me mandatin e Kryetarit të Komunës, me mundësi ndërprerje para skadimit në rast shkarkimi apo dorëheqje.
4. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: z. Ali Nimanaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
 Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.82/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), nenit 4 nënparagrafi 2.1. i paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr.01/2018 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, nxjerr:

V E N D I M

1. z. **Agim Ademaj**, Jurist i diplomuar, me vendbanim në Istog, Komuna e Istogut, emërohet: Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës.
2. Shefi i Kabinetit, i cekur më lartë, do t'i kryejë punët administrativo-teknike, duke përfshirë ofrimin e mbështetjes Kryetarit të Komunës në realizimin e përgjegjësi të tij; do të aranzhojë dhe njoftojë Kryetarin me takimet të cilat i ka të caktuara apo takime të ndryshme të cilat do të caktohen nga Kryetari, që janë në natyrën e punës së Kabinetit të Kryetarit.
3. I përmenduri me kryerjen e punëve dhe përgjegjësi të Shefit të Kabinetit do t'ia fillojë më 01.03.2022 dhe mandati i tij zgjatë sa mandati i Kryetarit të Komunës.
4. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.01/2018 MAPL për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna.
5. Obligohet Zyrtari Financiar për Paga, Meditje dhe Kompenzime të pëfshijë të përmendurin në listën e pagave e pagës të fillojë nga data e cekur në pikën 3. Të këtij Vendim, në pajtim me procedurat në fuqi.
6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Menaxheri i Personelit dhe Zyrtari Financiar për Paga, Meditje dhe Kompenzime.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: z. Agim Ademaj, Menaxheri i Personelit, Zyrtari Financiar për Paga, Meditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.84/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Naim Behlulaj**, Historian i Diplomuar, nga Fshati Uçë, Komuna e Istogut, caktohet Drejtor i Drejtorisë për Arsim.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtori i Drejtorisë së Arsimit do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Naim Behlulaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i,
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.85/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Xhevat Demaj**, nga Vrella, Komuna e Istogut, caktohet Drejtor i Drejtorisë për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtori i Drejtorisë së Emergjencave, Mbrojtjes dhe Shpëtimit do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Xhevat Demaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.


K r y e t a r i,
Ilir Ferati

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.86/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Merita Muzlijaj-Bytyçi**, master në shkenca mjekësore- edukim në kujdesin shëndetësor , nga Istogu caktohet Drejtoreshë e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtoresha e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. E përmendura do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Merita Muzlijaj- Bytyçi, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.87/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Agon Dreshaj**, Jurist i Diplomuar, nga Fshati Vrellë, Komuna e Istogut, caktohet Drejtor i Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtori i Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Agon Dreshaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i,
Ilir Ferati




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.88/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Kushtrim Buleshkaj**, jurist i diplomuar, nga Istogu i Poshtëm, Komuna e Istogut, caktohet Drejtor i Drejtorisë për Inspektion.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtori i Drejtorisë së Inspektionit do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Kushtrim Buleshkaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.89/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Zenel Shatri**, Specialist i Infektologjisë, nga Tomoci, Komuna e Istogut, caktohet Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Zenel Shatri, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.90/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Abedin Kabashi**, Master i Makinerisë, nga Tomoci, Komuna e Istogut, caktohet Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Abedin Kabashi, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.91/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Genc Ademaj**, Ekonomist, nga Lubova, Komuna e Istogut, caktohet Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Genc Ademaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i,
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.92/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Dukagjin Hoxhaj**, Inxhinier i Komunikacionit Rrugor, nga Prekalla, Komuna e Istogut, caktohet Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Dukagjin Hoxhaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.


K r y e t a r i,
Ilir Ferati

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.93/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58, pikat: b), c), e), f) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Sipas këtij vendimi **AUTORIZOHET Genc Ademaj**, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim përkohësisht t'i kryej punët dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë shtesë i lartcekuri do t'i ushtrojë në mungesë të Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për shkak të interesit të përgjithshëm të institucionit dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
3. I autorizuari do të marr pagën vetëm për pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim.
4. Autorizimi vlen deri në emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Genc Ademaj dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i,
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.94/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Arben Kabashi**, baçellor i Administratës Publike, nga Gurrakoci, Komuna e Istogut, caktohet Drejtor i Drejtorisë për Administratë Publike.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtori i Drejtorisë për Administratë Publike do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Arben Kabashi, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i,
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.95/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Elianë Blakaj**, Fizioterapeute, nga Vrella, Komuna e Istogut, caktohet Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. E përmendura do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Elianë Blakaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i,
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSËDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.96/2022	Data: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 62, paragrafi 62.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe në nenin 74 paragrafi 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 të datës 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **Astrit Hajrizaj**, Infermier, nga Zhakova, Komuna e Istogut, caktohet Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Hidroekonomi dhe Pylltari.
2. Me ushtrimin e funksionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Hidroekonomi dhe Pylltari do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
3. I përmenduri do të realizon pagën në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë Nr.16/2008.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Astrit Hajrizaj, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

K r y e t a r i,
Ilir Ferati


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-97/022	Data: Datum: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) në bazë të nenit 38 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2019) dhe bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-22/2022 të datës 22.02.2022 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa me Nr.02-22/2022 të datës 22.02.2022 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, për intervistimin me gojë të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin Zyrtar/e i/e Lartë për Prokurimit të publikuar me datën 26.01.2022 në Zyrën e Kryetarit dhe KVLBK formohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. **Gëzim Ademaj**, Udhëheqës i Prokurimit, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Zizë Bujupaj**, Udhëheqëse e Sektorit për Arsime, anëtare;
- 1.3. **Fatmir Bytyçi**, Menaxher i Personelit, anëtar;
- 1.4. **Abedin Neziraj**, Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komunitete, anëtar dhe
- 1.5. **Genc Ademaj**, Zyrtar i lartë për Vlerësimin e Projekteve për Partneritet Publiko Privat, anëtar.

2. KVLBK zëvendësues është në këtë përbërje si me poshtë:

- 2.1. **Shefqet Imeraj**, Zyrtar i Prokurimit, Kryesues i Komisionit;
- 2.2. **Fjollë Berisha**, Zyrtare e Lartë e Personelit, anëtare;
- 2.3. **Jehona Arifaj**, Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime me Qytetar, anëtare;
- 2.4. **Muhamet Gusturanaj**, Udhëheqës i Sektorit për Integrim Evropian, anëtar;
- 2.5. **Esad Smakij**, Zyrtar për Buxhet dhe Financa, anëtar;

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset Komisioni.

Vendimi u dërgohet:

- Komisionit KVLBK-,
- Komisioni Zëvendësues,
- Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkiivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ





 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-98/022	Data: Datum: 22.02.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe nenit 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **SHFUQIZOHET:** Vendimi 01Nr.530/2021 i datës 30.09.2021 për caktimin e koordinatorit Hekuran Rugova për përcjelljen e projekteve të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim nga data 22.02.2022.
2. Me datën 22.02.2022 Genc Ademaj është emëruar, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dhe i autorizuar për Drejtorin për Buxhet dhe Financa i cili do ti kryej punët e këtyre drejtorive.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Genc Ademaj dhe Zyra e Kryetarit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Hekuran Rugova;
- Genc Ademaj, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim dhe i autorizuar për Drejtorin për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-99/022	Data: Datum: 24.02.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/2008), për Aktemërimin e Zyrtarëve Financiar të cilëve ju kërkohet qasje në SIMFK për vitin 2022, nxjerr:

V E N D I M

1. EMËROHEN: Zyrtaret Financiar e poshtë shënuar për Qasje në SIMFK 2022

	Zyrtarët Financiar	Pozita,aktuale si pasë Aktemrimit	Pozita në SIMFK 2022
1	Gani Sylaj	Zyrtar I Lartë për Buxhet dhe Finaca	Çertifikues -aprovues
2	Naim Dervishaj	Zyrtar I Lartë për Buxhet dhe Finaca	Zyrtar Shpenzues
3	Riart Bytyqi	Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore	Zyrtar Zotues
4	Shahe Ferizaj	Zyrtare e të Hyrave Financiare	Zyrtare e te Hyrave
5	Shahe Ferizaj	Zyrtare e të Hyrave Financiare	Zyrtare alternative e pasurisë
6	Gezim Ademaj	Udhëheqes I Prokurimit	Gjenerues i Urdherblerjeve
7	Skender Hakaj	Zyrtar I Lartë për Buxhet dhe Finaca	Zyrtar për Nënaloqime
8	Brahim Hetemaj	Udhëheqes I Sektorit të Shëndetësisë	Zyrtar Alternativ Qertifikues -Aprovues
9	Avenita Selmanaj	Zyrtare e Pasurisë	Zyrtare e Pasurisë
10	Avenita Selmanaj	Zyrtare e Pasurisë	Zyrtare Alternative per Shpenzime
11	Esad Smakiq	Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2	Zyrtar i Pranimit te Mallit

2. Obligohen që të përdorin SIMFK sipas Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisitë dhe akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: ZKF dhe Zyrtaret e cekur në piken 1 te këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

-ZKF,

-MFPT-DTHK,

-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.100/2022	Data: 24.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58, pika f) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 4, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.3 dhe nenin 9 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr. 01/2018 për Caktimin e Stafit mbështetës në Komuna, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. **Alketa Bujupaj - Bytyçi**, baçellor i Shkencave Politike dhe Administratës Publike, nga Istogu, Komuna e Istogut, emërohet Asistente Administrative në Kabinetin e Kryetarit të Komunës.
2. E lartcekura, punët administrative-teknike duke përfshirë ofrimin e ndihmës në kryerjen e punëve të stafit të Kabinetit të Kryetarit; do të njoftojë Kryetarin me takimet të cilat i ka të caktuara apo takime të ndryshme të cilat do të caktohen si dhe punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat do t'i caktohen nga Kryetari që janë në natyrën e punës së Kabinetit të Kryetarit.
3. E lartpërmendura kryerjen e punëve dhe përgjegjësiive të Asistentes Administrative do t'ia fillojë nga: 01.03.2022.
4. E lartpërmendura pagën do të realizojë në pajim me Udhëzimin Administrativ (MAPL-së) Nr. 02/2014 dhe Udhëzimin Administrativ (MAP-së) Nr. 01/2014 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna.
5. Obligohet Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime të përfshijë të përmendurën në listën e pagave sipas vendimit të mëhershëm 01 Nr. 382/018 të datës 10.07.2018 dhe me marrjen e pagës të fillojë nga data e cekur në pikën 3 të këtij vendimi në pajtim me procedurat në fuqi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Menaxheri i Personelit dhe Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime.
7. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Alketa Bujupaj- Bytyçi, Menaxheri i Personelit, Zyrtarja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës,
Ilir Ferati



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-101/2022	Data: Datum: 24.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-1307, të datës 10.01.2022, të parashtruar nga z.Gjeral Zeqiraj nga fsh.Prigodë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes se tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-1307, të datës 10.01.2022, e parashtruar nga z.Gjeral Zeqiraj, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore, dhe i lejohen 200 litra karburant për 20 seanca, sipas raportit të mjekut specialist në QKUK.
2. Parashtruesi i kërkesës:z.Gjeral Zeqiraj, obligohet që pas përfundimit të seances se 10 ti sjellë raportet e mjekut për vizitat e realizuara, në të kundërtën i nderpritet furnizimi i metutjeshëm
3. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Gjeral Zeqiraj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
5. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Gjeral Zeqiraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-1307, të datës 10.01.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Nebahate Zeqiraj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për në Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Gjeral Zeqiraj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrosë së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-102/2022	Data: Datum: 25.02.2022	

Kryetari i Komunës, bázuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1, pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014) shqyrtoi kërkesën Nr. 01-016-7378 e datës 24.02.2022 e parashtruar nga Ismet Demaj, Udhëheqës i Ansamblit “ Selman Kadria “ dhe nxjerr këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr. 01-016-7378 e datës 24.02.2022 e parashtruar nga Ismet Demaj, Udhëheqës i Ansamblit “ Selman Kadria “ në Istog, për ofrimin e 50 litrave naftë me qëllim të pjesëmarrjes në festivalin e folklorit “ Luhtarëve të gjithë Kosovës “ i cili do të mbahet më 26 dhe 27.02.2022 në Glllogjan, Deçan. Ofrimi i naftës do të bëhet prej kategorisë ekonomike mallra dhe shërbime nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
3. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ismet Demaj, Udhëheqës i Ansamblit “ Selman Kadria “ në Istog ka parashtruar kërkesën Nr. 01-016-7378 e datës 24.02.2022 me të cilën ka kërkuar t'i ofrohen derivate të naftës sipas qëllimit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Me rastin e parashtrimit të kërkesës i lartpërmenduri ka bashkëngjitur edhe ftesën për organizimin në fjalë.

Siç u theksua u vendos si në dispozitiv . Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ismet Demaj, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.105/2022	Data: 25.02.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënpragrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale për Arsim 05.Nr.73/2022 të datës 23.02.2022, për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Noc Gegaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Gjuhës Shqipe, në SHFMU “Bajram Curri” në Istog, nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 05.Nr.73/2022 e datës 23.02.2022 e parashtruar nga Drejtoria Komunale për Arsim për kompenzimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Noc Gegaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Gjuhës Shqipe, në SHFMU “Bajram Curri” në Istog.
- 2.** Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **03.03.2022**.
- 3.** Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
- 4.** Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime, obligohet që Noc Gegaj t’ia bëjë pagesën e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.
- 5.** Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Inspektoratit të Punës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Noc Gegaj;
- Drejtorisë Komunale për Arsim;
- Zyrtarit Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
 z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.106/2022	Data: 25.02.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale për Arsim 05.Nr.74/2022 të datës 24.02.2022, për kompensimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Zymer Berishaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Gjuhës Shqipe, në SHFMU "Bajram Curri" në Istog, nxjerr:

V E N D I M


- MIRATOHET:** kërkesa 05.Nr.74/2022 e datës 24.02.2022 e parashtruar nga Drejtoria Komunale për Arsim për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Zymer Berishaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Gjuhës Shqipe, në SHFMU "Bajram Curri" në Istog.
- Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **06.03.2022**.
- Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
- Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime, obligohet që Zymer Berishaj t'ia bëjë pagesën e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Inspektoratit të Punës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Zymer Berishaj;
- Drejtorisë Komunale për Arsim;
- Zyrtarit Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ




 Kryetari i Komunës
 z.Illir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.107/2022	Data: 25.02.2022	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënpragrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale për Arsim 05.Nr.75/2022 të datës 24.02.2022, për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Shefqet Kabashi, me titull të postit: Mësimdhënës i mësimit klasor(1-5), në SHFMU “Bajram Curri” në Istog, nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 05.Nr.75/2022 e datës 24.02.2022 e parashtruar nga Drejtoria Komunale për Arsim për kompenzimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Shefqet Kabashi, me titull të postit: Mësimdhënës i mësimit klasor(1-5), në SHFMU “Bajram Curri” në Istog.
2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **17.03.2022**.
3. Pagesa e mjeteve të çekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë Komunale për Arsim, obligohet që Shefqet Kabashi t'ia bëjë pagesën e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Inspektoratit të Punës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Shefqet Kabashi;
- Drejtorisë Komunale për Arsim;
- Zyrtarit Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
 z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-108/022	Data: Datum: 25.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 12 paragrafi 12.3 të Ligjit Nr.04/L-081 për Shërbime Sociale dhe Familjare, nenin 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2011 për punët dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpinë me bazë në komunitet, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për lejimin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, shqyrtoi kërkesën Nr.06-016-53178 të datës 10.12.2021, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Pejës, për lejimin e strehimit të përherëshëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Muhamet(Ukë)Nitaj me vendbanim në rrugën "Weslli Kllark" në Pejë dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-016-53178 të datës 10.12.2021, e parashtruar nga Qendra për Punë Sociale e Pejës për lejimin e strehimit të përherëshëm institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, për Muhamet(Ukë)Nitaj me nacionalitet shqiptar, me shtetësi kosovar i lindur me 13.10.1946, në fshatin Drenoc, Komuna e Pejës.
2. Komisioni për rastin e lartcekur ka vendos ti lejoj strehimin në periudhë kohore prej tre muaj me mundësi vazhdimi nëse ka sjellje të mira..
3. Përgjegjësi i Shtëpisë së Komunitetit në Gurakoc është përgjegjëse për përkujdesjen ndaj Muhamet(Ukë)Nitaj gjatë qëndrimit në këtë institucion si dhe përcjelljen e sjelljeve të tij.
4. Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së obligohet që të përcjell dhe të mbikqyrë gjendjen e të strehuarit në shtëpinë e komunitetit në Gurakoc.
5. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për lejimin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc, shqyrtoj kërkesën Nr.06-016-53178 të datës 10.12.2021 si dhe dokumentacionin e ofruar nga Qendra për Punë Sociale e Pejë, për strehimin e të moshuarit Muhamet(Ukë)Nitaj i cili tani me adresë të vendbanimit në rrugën "Weslli Kllark" në Pejë, është i vetëm dhe pa përkujdesje familjare kushtet e jetesës i ka të vështira, nuk ka as një anëtar të ngushtë të familjes, ka qenë i martuar e që bashkëshortja i ka vdekur ka pas një vëlla Bardhin i cili ka vdekur para disa viteve, ka edhe tre vëllezër dhe një motër nga babai por që ka pas kontakte të rralla me ta vetëm në dasma. Muhameti ka një pension kontributdhënës prej 180.00€, ka pas një banesë e pas vdekjes së bashkëshortes e ka shitë banesën, të afërmit i kanë premtuar se do të kujdesen për te e ja kanë marr eurot e vetëm disa dite janë kujdesur për te. Nga të dhënat dhe raportet mjekësore ka konstatuar se nuk vërehet ndonjë sëmundje ngjitëse apo psikike e të lartcekurit, është i sjellshëm, vërehet se ka nevojë për kujdes dhe pastërti për arsye se kushtet ku jeton janë jo të mira. Komisioni ka vendos ti lejoj strehimin si në pikën 2 të këtij Vendimi dhe ka konstatuar se duhet t'i lejohet strehimi institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gurakoc.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Muhamet(Ukë)Nitaj;
- Drita Kelmendi-Kukaj, Drejtoresh e QPS-së në Pejë;
- Haki Ibrahimaj-Drejtor i QPS-së Istog;
- Menaxheri i shtëpisë së komunitetit në Gurakoc dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-109/2022	Data: Datum: 25.02.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 24.02.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektin: “Shërbime konsulentë individuale për nevojat e komunës së Istogut-katër konsulent”; nxjerr:

V E N D I M

1. CAKTOHET: Menaxher i kontratës **Valbona Kaliqanaj**, Zyrtare e Lartë për Pemëtari në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Fadil Kabashi**, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për projektin: Lot1 “Një konsulent individual për pranimin e aplikacioneve të fermerëve në Istog”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-447-2-2-1/C543 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-001-321, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori konsulentë Gentrira Salihaj nga Gurrakoci, Lot2 Një konsulent individual për pranimin e aplikacioneve të fermerëve në Istog”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-447-2-2-1/C544 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-001-321, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori konsulentë Dardan Blakaj nga f.sh Kovrag, Lot3 Një konsulent individual për pranimin e aplikacioneve të fermerëve në Istog”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-447-2-2-1C545 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-001-321, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori konsulentë Qëndrim Kajtazaj nga f.sh Dragolevc, Lot4 Një konsulent individual për pranimin e aplikacioneve të fermerëve në Istog”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-447-2-2-1C546 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-001-321, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori konsulentë Kaltrina Kukleci nga f.sh LLuga.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nënin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.

3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi u dërgohet:

- Valbona Kaliqani-Menaxher i kontratës
- Fadil Kabashit-Mbikëqyrës i Drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës;
- Gentrira Salihaj-operatori konsulentë;
- Dardan Blakaj-operator konsulentë;
- Qendrim Kajtazaj-operator konsulentë;
- Kaltrina Kukleci-operator konsulentë dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ





Zyrtari Kryesor Administrativ
Z. Ilir FERATI